



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:072863
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05658906

CAP.nr.913/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Liridon Maloku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit F/Kosovë, të cilën e përfaqëson Drejtori i Përgjithshëm A.K, ndaj debitorit A.M, në bazë të dokumentit përmbarues Marrëveshja/Kontrata e huasë nr.217052 e datës 31.01.2022, marrëveshja e pengut, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, EP.nr.23/23 të datës 07.03.2024, me datën 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit F/Kosovë dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, EP.nr.23/23 të datës 07.03.2024.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, EP.nr.23/23 të datës 07.03.2024, ka vendosur si vijon:

I.PRANOHET I BAZUAR prapësimi i debitorit A.M, ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri i Përmbaruesit Privat F.Sh P.nr.39/23 të datës 24.02.2023 dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore.

II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljes thelbore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datë 24.02.2023, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit në bazë të Marrëveshjes/Kontratës së huas nr.217052 e datës 31/01/2022, Marrëveshja e pengut në MTI dhe gjendja e pagesës e datës 22/02/2023, lidhur me borxhin në vlerë prej 1013.40 euro. Përmbarruesi Privat, ka lejuar përmbarrimin e kërkuar me urdhrin përmbarrimor P.nr.39/23 të datës 24.02.2023. Kundër urdhrin për përmbarrim, debitori me datën 07.03.2023, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori me datën 10.03.2023, ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar, duke arsyetuar se Përmbarruesi Privat F.Sh me Urdhrin P.nr.39/23 të datës 24.04.2023 ka lejuar përmbarrimin në bazë të Marrëveshjes/Kontrata e huas nr.217052 e datës 31.01.2022, marrëveshja e pengut. Gjykata pas shqyrtimit të dokumentit përmbarrimor në bazë të të cilit është lejuar përmbarrimi, përkatësisht shtojca 4 e kësaj marrëveshje ku palët janë pajtuar që sendet e caktuara si në kontratë të lihen peng dhe është përcaktuar se këto sende do të regjistroheshin në regjistrin e pengut sipas ligjeve të zbatueshme në Republikën e Kosovës, gjen se në shkresat e lëndës nuk ka prova se këto sende janë regjistruar si peng në zyrën përkatëse për regjistrimin e sendit. Andaj, gjykata vlerëson se kjo kontratë nuk përbën titull përmbarrimor, pasi që e njëjta nuk është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengjeve, andaj duke u bazuar në nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore dhe nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 1.7a, ku shprehimisht përcaktohet se: *1. Dokumente përmbarruese janë: 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut dhe nenin 71 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. të LPP-së, ku përcaktohet se: 1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marrë vendimi përmbarrues ose urdhri përmbarrues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, përkatësisht aprovoi si të bazuar prapësimin dhe shfuqizoi urdhrin për lejimin e përmbarrimit.*

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore, gjegjësisht kreditori edhe në procedurën ankimore me asnjë provë materiale nuk ka arritur të provon faktin vendimtar se Marrëveshja për Pengun e ka të regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut në MTI edhe përkundër asaj se kreditori në propozimin për përmbarrim një fakt të tillë e pretendon se ekziston, por nuk e vërteton me asnjë provë materiale e që në rastin konkret, rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë është kujdesur lidhur me bazën juridike mbi të cilën është lejuar përmbarrimi i propozuar e të cilin përfundim e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, po ashtu drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, megjithatë kjo nuk e pengon kreditorin që të drejtën e vet subjektive të realizoj në kontest të rregullt gjyqësor ose me rastin e sigurimit të provës se Kontrata për pengun

është regjistruar pranë organit kompetent, atëherë e njëjta mundet të inicioj serish procedurën përmbartimore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CAP.nr.913/24, me datë 07.05.2024

Gjyqtari
Liridon Maloku